


# Tregtia e jashtme e mallrave

## Nëntor, 2022

**Tiranë, më 19 Dhjetor 2022:** Në Nëntor 2022 eksportet e mallrave arritën vlerën 42 mld lekë, duke u rritur me 12,9 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe me 10,2 %, në krahasim me Tetor 2022. Importet e mallrave arritën vlerën 77 mld lekë, duke u ulur me -3,9 %, në krahasim me një vit më parë dhe me -7,1 %, në krahasim me Tetor 2022. Deficiti tregtar i këtij muaji është 35 mld lekë, duke u ulur me -18,5 %, krahasuar me Nëntor 2021 dhe me -21,8 %, në krahasim me Tetor 2022.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)




Në këtë njëmbëdhjetëmuor eksportet e mallrave arritën vlerën 447 mld lekë, duke u rritur me 32,6 %, ndërkohë importet e mallrave arritën vlerën 856 mld lekë, duke u rritur me 20,1 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 409 mld lekë, duke u rritur me 8,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2021.

### Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Gjatë muajit Nëntor 2022, në rritjen e eksporteve prej 12,9 %, pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +6,2 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me +5,5 pikë përqindje, “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +3,0 pikë përqindje. Ndërsa negativisht ka ndikuar grupi: “Materiale ndërtimi dhe metale” me -4,7 pikë përqindje.

**Fig. 2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Nëntor 2022**




Eksportet, gjatë këtij njëmbëdhjetëmujori janë rritur me 32,6 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të eksporteve, janë: “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +9,7 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +7,7 pikë përqindje, dhe “Tekstile dhe këpucë” me 6,5 pikë përqindje.

**Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:**

Gjatë muajit Nëntor 2022, në uljen e importeve prej -3,9 %, krahasuar me Nëntor 2021, kanë ndikuar negativisht grupet: “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me -8,2 pikë përqindje, “ Ushqime, pije, duhan” me -0,6 pikë përqindje dhe “Lëkurë dhe artikujt prej tyre” me -0,2 pikë përqindje. Ndërsa pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +2,6 pikë përqindje dhe “Materiale ndërtimi dhe metale” me +1,6 pikë përqindje.

**Fig. 3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Nëntor 2022**



Si njëmbëdhjetëmujor, importet janë rritur me 20,1 %, krahasuar me njëmbëdhjetëmujorin e parë 2021. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të importeve, janë: “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +8,2 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +3,8 pikë përqindje dhe “ Ushqime, pije, duhan” me +2,7 pikë përqindje.

**Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere**


Në muajin Nëntor 2022, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Nëntor 2021 janë: Itali (11,1 %), Spanja (74,1 %) dhe Maqedoni (68,3 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Kosova (9,3 %) ,Greqia (4,0 %) dhe Kina (26,6 %).

Gjatë këtij njëmbëdhjetëmujori vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Itali (38,6 %), Gjermani (67,6 %) dhe Greqia (18,5 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Kosova (1,1 %) dhe Spanja (6,2 %) .

Në muajin Nëntor 2022, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritjen më të madhe, janë: Turqia (14,8 %), Kina (13,4 %) dhe Gjermania (5,6 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe të importeve, në krahasim me Nëntor 2021 janë: Italia (5,2 %), Greqia (24,9 %) dhe Maqedonia (24,3 %).

Gjatë këtij njëmbëdhjetëmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (7,4 %), Turqia (36,9 %) dhe Greqia (22,4 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: SHBA (11,2 %), Rusia (20,9 %) dhe Zvicra (34,0 %).

**Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Nëntor 2022**



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE-së zënë 61,3 %, të gjithë tregtisë. Në Nëntor 2022, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 75,1 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 53,7 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (30,4 %), Turqia (9,3 %), Kina (5,9 %) dhe Greqia (5,7 %).

Shkëmbimet tregtare, për njëmbëdhjetëmujorin 2022, me vendet e BE-së zënë 59,8 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Nëntor 2022, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 74,0 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 52,3 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (29,5 %), Turqia (8,5 %), Greqia (7,0 %) dhe Gjermania (6,4 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave, Nëntor 2022

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2000		37	-23.5	157	-1.5	-120	23.6
2001		44	19.1	190	21.0	-146	23.2
2002		47	7.7	210	10.6	-163	22.6
2003		54	14.7	226	7.4	-172	24.1
2004		62	14.0	236	4.5	-174	26.3
2005		66	6.0	262	11.1	-196	25.1
2006		77	17.6	299	14.1	-222	25.9
2007		97	25.5	376	25.8	-279	25.8
2008		113	15.8	440	16.9	-327	25.6
2009		105	-7.2	429	-2.5	-324	24.4
2010		162	54.6	478	11.4	-316	33.8
2011		197	21.9	544	13.9	-347	36.2
2012		213	8.2	528	-2.9	-315	40.3
2013		246	15.7	517	-2.1	-271	47.6
2014		256	3.8	552	6.7	-296	46.3
2015		243	-4.9	545	-1.4	-302	44.7
2016		243	0.1	579	6.4	-336	42.0
2017		273	12.1	626	8.1	-353	43.6
2018		310	13.7	641	2.4	-331	48.4
2019		299	-3.8	649	1.2	-350	46.0
2021		272	-9.0	605	-6.8	-333	44.9
2019	01 - 19	22	-7.3	42	-6.2	-20	51.9
	02 - 19	23	-5.3	50	8.5	-27	45.4
	03 - 19	28	2.7	56	1.4	-28	49.6
	04 - 19	27	0.1	57	8.9	-30	46.7
	05 - 19	28	-8.0	59	4.0	-31	47.0
	06 - 19	26	-4.1	53	-1.4	-28	47.9
	07 - 19	28	3.7	60	2.7	-32	46.4
	08 - 19	20	-1.8	52	7.1	-32	38.8
	09 - 19	25	5.0	52	-14.2	-27	47.8
	10 - 19	27	-10.2	59	1.8	-32	45.6
	11 - 19	25	-9.0	53	-5.6	-28	46.7
	Janar - Nëntor 19	277	-4.1	594	2.1	-317	46.6
2020	01 - 20	23	5.3	42	-0.4	-19	54.9
	02 - 20	25	10.6	52	3.9	-27	48.3
	03 - 20	18	-36.0	44	-20.8	-27	40.1
	04 - 20	15	-44.2	36	-36.4	-21	41.0
	05 - 20	22	-22.5	45	-24.2	-23	48.1
	06 - 20	23	-9.6	52	-2.4	-29	44.3
	07 - 20	25	-11.5	57	-5.0	-32	43.3
	08 - 20	19	-3.4	48	-6.7	-29	40.2
	09 - 20	25	-1.2	52	-1.8	-27	48.2
	10 - 20	27	-0.5	59	0.1	-32	45.3
	11 - 20	27	10.6	56	5.2	-28	49.1
	Janar - Nëntor 20	249	-10.1	544	-8.4	-295	45.8
2021	01 - 21	24	3.1	45	8.4	-22	52.3
	02 - 21	25	-0.9	52	0.9	-27	47.4
	03 - 21	32	78.1	64	45.3	-33	49.2
	04 - 21	29	92.3	63	72.9	-34	45.6
	05 - 21	33	52.7	62	38.4	-29	53.0
	06 - 21	35	50.8	67	28.9	-32	51.9
	07 - 21	32	30.6	72	26.1	-39	44.8
	08 - 21	24	22.5	61	26.2	-37	39.0
	09 - 21	33	43.3	69	32.4	-36	48.0
	10 - 21	34	26.3	77	29.2	-43	44.3
	11 - 21	37	36.3	81	44.4	-43	46.3
	Janar - Nëntor 21	337	35.4	713	31.1	-376	47.3
2022	01 - 22	35	47.5	55	21.1	-20	63.6
	02 - 22	37	50.5	69	31.5	-31	54.3
	03 - 22	48	50.4	84	29.7	-36	57.1
	04 - 22	42	46.6	78	23.7	-36	54.0
	05 - 22	45	36.8	80	28.6	-35	56.4
	06 - 22	46	32.2	81	20.8	-35	56.8
	07 - 22	39	23.0	82	14.1	-42	48.3
	08 - 22	35	48.1	80	30.8	-44	44.2
	09 - 22	39	16.3	88	27.4	-49	43.8
	10 - 22	38	12.5	83	8.6	-45	45.9
	11 - 22	42	12.9	77	-3.9	-35	54.4
	Janar - Nëntor 22	447	32.6	856	20.1	-409	52.2

Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë), Nëntor 2022

	Eksporte				Importe			
	Nëntor 2021	Nëntor 2022	Janar - Nëntor 2021	Janar - Nëntor 2022	Nëntor 2021	Nëntor 2022	Janar - Nëntor 2021	Janar - Nëntor 2022
<b>Vendet e BE-së</b>	<b>26.403</b>	<b>31.640</b>	<b>242.043</b>	<b>330.557</b>	<b>41.915</b>	<b>41.566</b>	<b>343.856</b>	<b>447.627</b>
Austri	263	1.014	2.409	5.323	745	536	6.355	6.186
Gjermani	1.696	1.740	17.986	30.149	4.422	4.668	49.886	53.294
Greqi	2.061	1.979	19.668	23.309	6.379	4.790	55.870	68.362
Itali	15.979	17.755	141.334	195.895	19.533	18.508	175.089	188.056
Spanjë	2.209	3.845	22.092	20.717	1.120	1.220	10.487	14.825
Kroaci	714	604	2.939	6.777	648	1.254	6.995	9.600
Të tjera të BE-së	3.481	4.702	35.614	48.387	9.069	10.589	81.088	107.304
Mbretëri e Bashkuar	105	193	844	2.003	538	525	5.846	6.794
Kinë	1.114	818	8.373	9.110	5.517	6.254	58.807	68.308
Kosovë	4.059	3.682	35.022	34.635	2.011	1.079	12.645	14.367
Maqedonia e Veriut	1.275	2.146	11.665	16.036	1.567	1.186	12.063	14.059
Rusi	3	-	12	43	1.750	738	13.067	10.339
SHBA	765	607	4.429	12.673	689	1.023	13.796	12.246
Turqi	405	713	4.991	5.962	9.052	10.394	76.488	104.739
Ukrainë	15	89	288	549	595	395	3.378	3.880
Zvicër	244	64	2.315	2.709	2.211	866	10.933	7.214
Të tjera	2.918	2.158	26.885	32.285	14.673	13.316	120.080	166.240
<b>Gjithsej</b>	<b>37.306</b>	<b>42.110</b>	<b>336.868</b>	<b>446.563</b>	<b>80.518</b>	<b>77.343</b>	<b>712.874</b>	<b>855.813</b>

Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë), Nëntor 2022

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Nëntor 2021	Nëntor 2022	Janar - Nëntor 2021	Janar - Nëntor 2022	Nëntor 2021	Nëntor 2022	Janar - Nëntor 2021	Janar - Nëntor 2022
<b>Gjithsej</b>	<b>37.306</b>	<b>42.110</b>	<b>336.868</b>	<b>446.563</b>	<b>80.518</b>	<b>77.343</b>	<b>712.874</b>	<b>855.813</b>
Ushqime, pije, duhan	4.383	5.062	40.278	46.240	11.856	11.386	117.337	136.668
Minerale, lëndë djegëse, en,el,	6.608	8.908	63.204	95.800	17.154	10.519	87.012	145.122
Produkte kimike dhe plastike	1.143	1.209	9.658	16.437	9.559	10.269	102.254	107.070
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	250	273	1.977	2.643	1.532	1.361	13.546	15.731
Prodhime druri dhe letre	1.149	1.402	9.228	13.209	3.002	2.912	25.998	32.229
Tekstile dhe këpucë	10.826	12.874	102.607	124.552	8.743	9.098	82.068	93.478
Materiale ndërtimi dhe metale	9.067	7.319	73.790	99.878	11.545	12.807	100.784	127.944
Makinëri, pajisje dhe pj, këmb,	2.833	3.960	26.440	36.285	14.038	16.171	153.006	166.564
Të tjera	1.046	1.102	9.686	11.519	3.089	2.820	30.869	31.007

**Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Nëntor 2022**

	Itali		Kosovë		Gjermani		Greqi	
	2021	2022	2021	2022	2021	2022	2021	2022
<b>Gjithsej</b>	<b>141.334</b>	<b>195.895</b>	<b>35.022</b>	<b>34.635</b>	<b>17.986</b>	<b>30.149</b>	<b>19.668</b>	<b>23.309</b>
Ushqim, pije duhan	10.363	10.492	4.207	5.063	1.546	1.655	3.453	3.874
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	1.641	17.966	7.669	5.830	4.659	16.404	6.928	3.357
Produkte kimike dhe plastike	2.885	4.698	2.856	3.705	67	59	711	3.136
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	1.755	2.432	15	13	37	13	14	34
Prodhime druri dhe letre	5.755	7.980	830	1.368	239	290	1.345	1.925
Tekstile dhe këpucë	80.657	97.224	158	158	6.790	7.645	4.467	5.144
Materiale ndërtimi dhe metale	20.698	31.292	16.489	15.401	2.222	1.182	2.159	4.959
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	13.039	18.347	1.456	1.630	2.037	2.437	85	124
Të tjera	4.544	5.465	1.341	1.466	389	465	506	756

**Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Nëntor 2022**

	Itali		Turqi		Kinë		Greqi	
	2021	2022	2021	2022	2021	2022	2021	2022
<b>Gjithsej</b>	<b>175.089</b>	<b>188.056</b>	<b>76.488</b>	<b>104.739</b>	<b>58.807</b>	<b>68.308</b>	<b>55.870</b>	<b>68.362</b>
Ushqim, pije duhan	22.115	26.185	6.222	5.754	920	1.361	14.777	16.722
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	10.984	5.391	4.519	10.602	11	10	10.906	18.548
Produkte kimike dhe plastike	21.435	22.712	9.989	11.740	7.716	6.611	8.463	9.179
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	11.114	12.395	384	516	668	861	33	49
Prodhime druri dhe letre	6.034	7.043	3.606	5.457	716	1.135	3.730	4.441
Tekstile dhe këpucë	38.838	45.212	17.452	17.446	10.641	11.632	3.182	4.042
Materiale ndërtimi dhe metale	23.190	24.805	20.100	37.423	5.023	7.663	10.016	9.387
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	35.158	37.276	9.864	11.112	27.296	32.427	3.095	4.462
Të tjera	6.221	7.038	4.353	4.689	5.816	6.608	1.668	1.532

# Metodologjia

Tregtia e Jashtme e mallrave është një publikim periodik mujor që paraqet tregtinë e mallrave të Shqipërisë me vendet e tjera të botës, Të dhënat e përpunuara nga INSTAT për këtë publikim janë të dhëna administrative të cilat merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

## Definicionet:

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv ose të rieksportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor,

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikën e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

## Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri